

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDIHMËSE NË VESHJE FASADASH”

Kodi: PK-B-14-25

Njësia e të nxënit të standardit të kualifikimit “Ndërtim”, K-B-II-25, Niveli II i KSHK-së:

1. NjN-02-II-0233-25 “Punime ndihmëse në veshje fasadash”
2. NjN-02-II-0226-25 “Materialet bazë në ndërtim”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2 Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Certifikimi sipas Nivelit të II të KSHK-së për njësinë e të nxënit “Punime ndihmëse në veshje fasadash” me kod 02-II-0233-25 dhe “Materiale bazë në ndërtim” me kod 02-II-0226-25 do të jepet nga IoAFP i akredituar sipas Urdhrit nr. 845, datë 03.07.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”

Tiranë, 2025

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDIHMËSE NË VESHJE FASADASH” “MATERIALE BAZË NË NDËRTIM”

(PK-B-14-25)

I. Profili profesional i punëtorit ndihmës në veshje fasadash.

a) Karakteristikat e punëtorit ndihmës në veshje fasadash.

Punëtori ndihmës në veshje fasadash do të kryejë detyra profesionale si i punësuar në kompani që kryejnë punime ndihmëse në veshje fasadash.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori ndihmës në veshje fasadash duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehje** praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të punëtorit ndihmës në veshje fasadash.

Suksesi i punëtorit ndihmës në veshje fasadash është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durimi, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punëtorit ndihmës në veshje fasadash.

Profesioni i punëtorit ndihmës në veshje fasadash është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve ndihmëse në veshje fasadash. Kursanti mund të punësohet në kompani që ofrojnë punime ndihmëse në veshje fasadash.

Me përmbushjen e të gjitha njësive të të nxëniet të standardit të kualifikimit “Ndërtim”, Niveli II i KSHK-së, si dhe me përvojë pune, kursanti mund të kalojë në nivelet e mëtejshme të KSHK-së.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale dhe aftësi të buta (soft skills) për të ushtruar disa veprimtari profesionale në profesionin: “Punëtorë të ndërtimit të banesave”, me kod 9313, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse në veshje fasadash”

Në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse në veshje fasadash” kursantët do të jenë të aftë:

- të ndihmojnë në organizimin e vendit të punës;
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- të komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të ndihmojnë në kryerjen e punimeve përgatitore;
- të ndihmojnë në kryerjen e përpunimit të materialeve të ndryshme, gjatë punës;
- të ndihmojnë në veshjen e fasadave me pllaka mermeri dhe betoni;
- të ndihmojnë në veshjen e fasadave me pllaka guri;
- të ndihmojnë në veshjen e fasadave me pllaka qeramike (tulle);
- të ndihmojnë në montimin e strukturës metalike;
- të ndihmojnë në montimin e shtresave në sistemin kapot;

- të ndihmojnë në montimin e shtresave në sistemin e venteluar;
- të zbatojnë standardet e profesionit, gjatë punimeve ndihmëse në veshjen e fasadave;
- të zbatojnë standardet e kodit të etikës në punë;
- të raportojnë për punën e kryer te eprorët, sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara;
- të respektojnë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

III. Kërkesat e pranimi në Kursin “Punime ndihmëse në veshje fasadash”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Punime ndihmëse në veshje fasadash” duhet të kenë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar dhe të jenë mbi 16 vjeç.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Punime ndihmëse në veshje fasadash”.

176 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime ndihmëse në veshje fasadash”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e ndihmësit në veshje fasadash	MK-B-432-25	15 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmësit në veshjen e fasadave. 2. Kursanti përshkruan llojet e ndryshme të veshjes së fasadave. 3. Kursanti zbaton rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2	Materialet bazë në veshje fasadash	MK-B-433-25	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan pllaka të llojeve të ndryshme për veshje fasadash. 2. Kursanti përshkruan materialet lidhëse për veshjen e fasadave. 3. Kursanti përshkruan materialet e shtresave në veshjen e fasadave, sipas funksionit të tyre.
3	Veshja e fasadave me sistemin kapot	MK-B-434-25	35 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës për veshjen e fasadave me sistemin kapot. 2. Kursanti ndihmon në përpunimin e materialeve për veshjen me sistemin kapot. 3. Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me sistemin kapot.
4	Fasadat e ventiluara në objektet e ndërtimit	MK-B-435-25	35 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës për fasadat e ventiluara. 2. Kursanti ndihmon në montimin e strukturës metalike. 3. Kursanti ndihmon në montimin e materialit izolues termik. 4. Kursanti ndihmon në montimin e paneleve të jashtme të fasadës.
5	Veshja e fasadave me pllaka të ndryshme	MK-B-436-25	61 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës për veshjen e fasadave me pllaka të ndryshme. 2. Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me pllaka mermeri dhe guri. 3. Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me pllaka betoni. 4. Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me pllaka qeramike (tulle).

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MEI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Punime ndihmëse në veshje fasadash”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e ndihmësit në veshje fasadash”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E NDIHMËSIT NË VESHJE FASADASH	MK-B-432-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi për të përshkruar veçoritë e profesionit të ndihmësit në veshjen e fasadave, llojet e ndryshme të veshjes së fasadave, si dhe për të zbatuar rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	15 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmësit në veshjen e fasadave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionet, detyrat, qëndrimet dhe përgjegjësitë kryesore të punonjësit ndihmës në veshje fasadash; - të përshkruajë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike; - të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit të veglave dhe vendit të punës; - të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me kolegët dhe eprorët; - të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; - të raportojë rregullisht te eprori për detyrën e dhënë; - të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë; - të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në vendin e punës. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.	
	RN 2 Kursanti përshkruan llojet e ndryshme të veshjes së fasadave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

- të lexojë shenjat dalluese të strukturave të ndërtimit;
- të lexojë shënimet teknike të dhëna në fletët e projektit për veshje fasadash;
- të lexojë skicat/detajet e dhëna për veshje fasadash me sisteme të ndryshme;
- të përshkruajë funksionalitetin e veshjes së fasadës;
- të përshkruajë llojet e veshjeve së fasadës, sipas vendndodhjes ndërtimore;
- të listojë llojet e ndryshme të veshjeve të fasadave, sipas materialit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 3 Kursanti zbaton rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
- të përshkruajë rëndësinë e rregullores së brendshme, si dhe sinjalistikën e kantierit të ndërtimit;
- të zbatojë sinjalistikën që përdoret në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e shëndetit në vendin e punës;
- të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti në vendin e punës;
- të përdorë pajisjet mbrojtëse (PMI) në vendin e punës, sipas rregullores përkatëse;
- të përshkruajë procedurën e evakuimit në raste emergjente;
- të përshkruajë rregullat përkatëse, gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes së distancave të rekomanduara në vendin e punës, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të sigurohet me mjetet e nevojshme për punimet në lartësi;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm, gjatë punës për veshje fasadash;
- të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së mbetjeve, sipas llojit;
- të shpjegojë mënyrën e transportimit të mbeturinave, sipas llojit të ndarjes në vendin e duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime për veshje fasadash.

-
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra për të përshkruar veçoritë e profesionit të ndihmësit në veshjen e fasadave, llojet e ndryshme të veshjes së fasadave, si dhe për të zbatuar rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul për të përshkruar veçoritë e profesionit të ndihmësit në veshjen e fasadave, llojet e ndryshme të veshjes së fasadave, si dhe për të zbatuar rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për veshje fasadash.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Materialet bazë në veshje fasadash”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MATERIALET BAZË NË VESHJE FASADASH	MK-B-433-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi praktike për të përshkruar llojet e ndryshme të pllakave për veshje fasadash, materialet lidhëse të tyre, si dhe materialet e shtresave në veshjen e fasadave.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar, të jenë mbi 16 vjeç, si dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e ndihmësit në veshje fasadash”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan pllaka të llojeve të ndryshme për veshje fasadash. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë vetitë kryesore të pllakave; - të identifikojë llojet e pllakave, sipas përdorimit për veshje të ndryshme fasadash; - të përshkruajë llojet e pllakave veshëse, sipas funksionit të ndërtesës; - të dallojë llojet e pllakave, sipas vetive të tyre; - të përshkruajë materialet organike dhe ato inorganike; - të përshkruajë llojet e aksesorëve ndihmës për veshjen e fasadave. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim. RN 2 Kursanti përshkruan materialet lidhëse për veshjen e fasadave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e lidhësave në veshje fasadash, sipas kodit të përdorimit; - të lexojë përzierjen e lidhësave të ndryshme, sipas paketimit përkatës; - të përshkruajë mënyrën e përzierjes së materialit lidhës me tretësin, sipas udhëzimeve; - të shpjegojë raportet të përzierjes së përbërësve të llaçeve, sipas përdorimit; - të shpjegojë kohën e përzierjes së materialit patinues/stukues	

me ujë sipas punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan materialet e shtresave në veshjen e fasadave, sipas funksionit të tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë materialet e strukturës metalike;
- të përshkruajë materialet hidroizoluese;
- të përshkruajë materialet ventiluese;
- të përshkruajë materialet termoizoluese;
- të përshkruajë materialet akustike;
- të përshkruajë aksesoret ndihmës në veshje fasadash.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime për veshjen e fasadave. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. – Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra për të përshkruar llojet e ndryshme të pllakave për veshje fasadash, materialet lidhëse të tyre, si dhe materialet e shtresave në veshjen e fasadave. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul për të përshkruar llojet e ndryshme të pllakave për veshje fasadash, materialet lidhëse të tyre, si dhe materialet e shtresave në veshjen e fasadave. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedisë reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për veshje fasadash. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Veshja e fasadave me sistemin kapot”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VESHJA E FASADAVE ME SISTEMIN KAPOT	MK-B-434-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi për të ndihmuar në organizimin e punës për veshjen e fasadave me sistemin kapot, në përpunimin e materialeve për veshjen me sistemin kapot, si dhe në veshjen e e fasadave me sistemin kapot.	
Kohëzgjatja e modulit	35 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar, të jenë mbi 16 vjeç, si dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e ndihmësit në veshje fasadash”.	
Rezultatet e të nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës për veshjen e fasadave me sistemin kapot. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë; - të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; - të zbatojë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; - të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme (shpuese, prerëse dhe shënuese) për veshjen e fasadave me sistemin kapot; - të kontrollojë veglat e punës para përdorimit të tyre; - të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së skelës me konstruksionin e ndërtesës; - të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; - të koordinojë punën me kolegë, duke raportuar te eprori, sipas hierarkisë; - të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim. - Vlerësim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në përpunimin e materialeve për veshjen e fasadave me sistemin kapot. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të lexojë skica, detaje dhe simbole të thjeshta me fragmente punimesh me sistemin kapot;
- të ndihmojë në realizimin e matjeve dhe shënimeve për materialet hidroizoluese, termoizoluese e akustike për veshjen me sistemin kapot;
- të ndihmojë në realizimin e matjeve dhe shënimeve në profilet metalike horizontale dhe vertikale, membranën kundra erës;
- të ndihmojë në përpunimin e profileve metalike;
- të ndihmojë në realizimin e prerjes së fletëve të pllakave, sipas përmasave të materialeve dhe skicës së dhënë (hidroizoluese, termoizoluese e akustike, profilet metalike horizontale dhe vertikale, membranën kundra erës);
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në veshjen e e fasadave me sistemin kapot.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të pastrojë murin e fasadës nga pluhurat;
- të ndihmojë në piketimin e elementeve përbërëse në fasada;
- të ndihmojë në vendosjen e kornizës mbajtëse të profileve metalik në fasadë;
- të ndihmojë në fiksimin e paneleve termoizolues, hidroizolues, akustik, membranën kundra erës, sipas skicës së dhënë;
- të ndihmojë në fiksimin e e ribatinave të shkarkimit;
- të vendosë ngjitësin në pika mbi sipërfaqen e brendshme të panelit dhe t`a ngjisë panelin në fasadë;
- të ndihmojë në fiksimin e mbërthyseve (upat), sipas skicës së dhënë;
- të shtrojë lidhësin me shpatull mbi sipërfaqen e panelit dhe me ndihmën e specialistit të vendosë rrjetën me fije xhami;
- të lyejë sipërfaqen me furçë/rul me “teknofiks likuid” (material i lëngshëm), duke siguruar një sipërfaqe të lëmuar;
- të shtrojë shtresën dekorative (fino klasike) me mallë metalike mbi sipërfaqen e lëmuar me ndihmën e specialistit;
- të kryejë mirëmbajtjen e punimeve të sistemit kapot nga agjentët atmosferike;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime për veshje fasadash me sistemin kapot. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. – Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra për të ndihmuar në organizimin e punës për veshjen e fasadave me sistemin kapot, në përpunimin e materialeve për veshjen me sistemin kapot, si dhe në veshjen e fasadave me sistemin kapot. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul për të ndihmuar në organizimin e punës për veshjen e fasadave me sistemin kapot, në përpunimin e materialeve për veshjen me sistemin kapot, si dhe në veshjen e fasadave me sistemin kapot. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime të veshjes së fasadave me sistemin kapot. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Fasadat e ventiluara në objektet e ndërtimit”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	FASADAT E VENTILUARA NË OBJEKTET E NDËRTIMIT	MK-B-435-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi për të ndihmuar në organizimin e punës për fasadat e ventiluara, për të montuar strukturën metalike, materialet izolues termik, si dhe panelet e jashtme të fasadës.	
Kohëzgjatja e modulit	35 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar, të jenë mbi 16 vjeç, si dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e ndihmësit në veshje fasadash”.	
Rezultatet e të nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës për fasadat e ventiluara. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë; - të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; - të zbatojë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; - të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme (shpuese, prerëse dhe shënuese) për veshjen e fasadave të ventiluara; - të kontrollojë veglat e punës para përdorimit të tyre; - të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së skelës me konstruksionin e ndërtesës; - të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; - të koordinojë punën me kolegë, duke raportuar te eprori, sipas hierarkisë; - të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim. - Vlerësim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në montimin e strukturës metalike. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;	

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të ndihmojë në përgatitjen e materialeve të nevojshme për montimin e strukturës metalike;
- të dallojë llojet e profileve mbajtës dhe elementet lidhëse që përdoren në fasadat e ventiluara;
- të ndihmojë në vendosjen e profileve, sipas shenjave të projektit dhe udhëzimeve të specialistit;
- të përdorë mjetet e punës në mënyrë të sigurt dhe korrekte;
- të ndihmojë në kontrollin e vertikalitetit dhe pozicionimit të profileve, gjatë montimit të strukturës metalike;
- të bashkëpunojë me ekipin për sigurimin e saktësisë dhe stabilitetit të strukturës;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve për montimin e strukturës metalike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në montimin e materialit izolues termik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të përdorë mjetet e punës (thikë teknike, shufra fiksuese, vida, rregullues), duke respektuar rregullat e sigurisë;
- të ndihmojë në përgatitjen e materialeve izoluese dhe pajisjet ndihmëse për fasadat e ventiluara;
- të ndihmojë në prerjen e izoluesve, sipas sipërfaqes;
- të ndihmojë në bashkimin e materialeve izoluese;
- të ndihmojë në vendosjen e shtresës izoluese mbi mur, duke respektuar drejtimin dhe mënyrën e fiksimit, sipas udhëzimeve të specialistit;
- të kontrollojë që shtresa izoluese të jetë e vendosur mirë dhe pa boshllëqe;
- të bashkëpunojë me anëtarët e grupit për sigurimin e cilësisë së punës;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve për montimin e materialit izolues termik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti ndihmon në montimin e paneleve të jashtme të fasadës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të përgatitë vendin e punës dhe materialet për montimin e paneleve të jashtme;
- të përshkruajë llojet e paneleve që përdoren në fasadat e ventiluara (alumini, qeramike, kompozitë, HPL, etj.);
- të përdorë mjetet dhe pajisjet e punës në mënyrë të sigurt dhe korrekte;
- të ndihmojë në transportin dhe pozicionimin e paneleve pranë zonës së montimit pa i dëmtuar ato;
- të ndihmojë në përshtatjen e paneleve, sipas përmasave të kërkuara nga projekti;
- të ndihmojë në fiksimin e paneleve në strukturën mbajtëse, sipas shenjave dhe udhëzimeve;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve për montimin e paneleve të jashtme të paneleve të jashtme të fasadës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime për veshje fasadash me ventilim.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra për të ndihmuar në organizimin e punës për fasadat e ventiluara, për të montuar strukturën metalike, materialet izolues termik, si dhe panelet e jashtme të fasadës.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul për të ndihmuar në organizimin e punës për fasadat e ventiluara, për të montuar strukturën metalike, materialet izolues termik, si dhe panelet e jashtme të fasadës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për fasadat e ventiluara.
-

-
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Veshja e fasadave me pllaka të ndryshme”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VESHJA E FASADAVE ME PLLAKA TË NDRYSHME	MK-B-436-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi për të ndihmuar në organizimin e punës, si dhe në veshjen e fasadave me pllaka mermeri, guri, betoni e qeramike (tulle).	
Kohëzgjatja e modulit	61 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar, të jenë mbi 16 vjeç, si dhe të kenë përfunduar modulin “Hyrje në profesionin e ndihmësit në veshje fasadash”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës për veshjene fasadave me pllaka të ndryshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë; - të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; - të zbatojë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; - të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave, mjeteve të nevojshme për veshjen e fasadave me pllaka të ndryshme; - të përzgjedhë aksesoret e duhur duke i grupuar (ganxhat e shufrat metalike), sipas emërimit përkatës dhe llojit të punimeve; - të ndihmojë në përpunimin e pllakave të mermerit, duke hapur vrimat për ganxhat; - të kontrollojë veglat e punës para përdorimit të tyre; - të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së skelës me konstruksionin e ndërtesës; - të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; - të koordinojë punën me kolegë, duke raportuar te eprori, sipas hierarkisë; - të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim. - Vlerësim me listë kontrolli.	

RN 2 Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me pllaka mermeri dhe guri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të pastrojë murin e fasadës nga papastërtitë;
- të kontrollojë me ndihmën e specialistit rrafshhtësinë dhe vertikalishtet e murit me mastar-nivelë;
- të ndihmojë në caktimin në fasadë të pozicionit për fillimin e punimeve të veshjes me pllaka mermerit dhe guri, sipas skicës së dhënë;
- të ndihmojë në fiksimin i ganxhave “grip” në pllaka, sipas vrimave të hapura;
- të stukojë material ngjitës boshllëqet e vrimave;
- të ndihmojë në futjen e fitilave prej çeliku në sipërfaqjen e fasadës sipas detajit;
- të ndihmojë saldatorin për lidhjen e fitilave me ganxhat vertikale të fiksuara në pllakat e gurit dhe mermerit;
- të ndihmojë specialistin për veshjen e fasadës me pllaka guri dhe mermeri, duke kontrolluar me instrumente niveluese;
- të ndihmojë në kontrollin e vazhdueshëm të veshjes për të evituar fuga, gjatë veshjes fasadave me pllaka mermeri;
- të përgatitë llaçin e çimentos me makineri, sipas raportit të dhënë;
- të mbushë me llaç çimento boshllëkun midis pllakave dhe murit;
- të lyejë me llak të specifikuar sipërfaqen e veshur me pllaka guri;
- të pastrojë sipërfaqen e lyer me llak të tepërt me shtupë;
- të kryejë luçidimin me mjete dore të sipërfaqes së veshur me pllaka mermeri;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve për veshjen e fasadave me pllaka mermeri dhe guri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me pllaka betoni.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të ndihmojë në fillimin e punimeve të veshjes me pllaka betoni të parapërgatitura, sipas skicës së dhënë;
- të ndihmojë në fiksimin e shufrave të hekurit në murin e

fasadës;

- të ndihmojë në fiksimin e pllakave të betonit, duke i lidhur me shufrat e lëna në mur dhe unazave që janë të ankoruara në pjesën e prapme të pllakave të betonit;
- të kontrollojë me ndihmën e specialistit vertikalitetin e veshjes së murit me mastar-nivelë;
- të ndihmojë në kontrollin e vazhdueshëm të veshjes për të evituar fuga horizontale gjatë montimit pllakave betonit;
- të mbushë boshllëkun midis pllakave dhe murit me llaç çimento;
- të pastrojë dhe luçidojë me mjete dore sipërfaqen e veshur;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve për veshjen e fasadave me pllaka betoni.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti ndihmon në veshjen e fasadave me pllaka qeramike (tulle).

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;
- të kontrollojë me ndihmën e specialistit rrafshësinë dhe vertikalitetin e murit me mastar-nivelë;
- të ndihmojë në caktimin në fasadë të pozicionit për fillimin e punimeve të veshjes me pllaka qeramike (tulle), sipas skicës së dhënë;
- të përgatitë ngjitësin e pllakave, sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në fiksimin me llaç të pllakave në formën e L në qoshet e fasadave;
- të ndihmojë në vendosjen e distancatorëve, sipas trashësisë fugës në drejtimin e spangos;
- të ndihmojë në veshjen me pllaka qeramike (tulle) të fasadës sipas konfiguracionit të dhënë;
- të ndihmojë në përpunimin e trashësisë fugave, sipas skicës;
- të pastrojë nga ngjitësi në kohën e duhur sipërfaqen e veshur me pllaka qeramike (tulle);
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës, para dhe pas punimeve për veshjen e fasadave me pllaka qeramike (tulle).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset

zbatimin e modulit	e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime për veshjen e fasadave me pllaka të ndryshme. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. – Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t`u jepen detyra për të ndihmuar në organizimin e punës, si dhe në veshjen e fasadave me pllaka mermeri, guri, betoni e qeramike (tulle). – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike për të ndihmuar në organizimin e punës, si dhe në veshjen e fasadave me pllaka mermeri, guri, betoni e qeramike (tulle). – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime veshjesh të fasadave me pllaka të ndryshme. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.